



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:243559
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05760115

KPPP.nr.110/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit NLB Banka SH.a., me seli në Prishtinë Rr.”Ukshin Hoti”, nr.124, kundër debitorëve 1.) “Manor Hause” Sh.P.K., me NRB:71135411, me seli në Prishtinë, Rr.”...” nr.11, 2.)M.R. nga Prishtina Rr.”Vëllezërit Fazliu” pn, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Zyra për Konsulencë Ligjore Laë Tech sh,p.k., me seli në Prishtinë Rr”Ndue Perllëshi” Lin Projekt-Ob-4/35, 3.) G.B. me adresë në Prishtinë Rr”...” nr.11, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Durim Osmni avokat nga Prishtina, 4).A.R. nga fshati Bërnice e Epërme, Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.110/2018 të datës 11.07.2018, të Përmbartuesit Privat Myjesere Mujku, me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit M.R. nga Prishtina, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.110/18 të datës 11.07.2018, të Përmbartuesit Privat Myjesere Mujku.
- II. LEJOHET kthimi në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit nga debitori G.B., ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.110/18 të datës 11.07.2018, të Përmbartuesit Privat Myjesere Mujku.
- III. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit G.B., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.110/18 të datës 11.07.2018, të Përmbartuesit Privat Myjesere Mujku.

IV. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.110/18 i datës 11.07.2018, i Përmbauesit Privat Myjesere Mujku.

A r s y e t i m

Zyra Përbarimore e Përmbauesit Privat Myjesere Mujku, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përbarimor me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të Kontratë Kornizë për Limit të Produkteve Kreditore për Biznes me numër 157-2909-15 e datës 29.09.2015, Kontratës për Kredi Biznesi me numër K0115/4128 e datës 29.09.2015, Kontratës për kredi Biznesi me numër K0116/844 e datës 11.03.2016, Marrëveshjes për Peng mbi llogarinë Bankare për Bashkëhuamarrësin me numër K0116/844 e datës 11.03.2016, Marrëveshjes Mbi Pengun me numër K0116/844 e datës 11.03.2016, Konfirmimin e Regjistrimit R-20160318-89 e datës 18.03.2016, Kontratës mbi Themelimin e Hipotekës me Nr.LRP.789/2015, Ref.1405/2015, Aktvendimit mbi regjistrimin e Hipotekës nr,001-954-6-1022/15 i datës 06.10.2015, ka urdhëruar të gjitha Institucionet Financiar se në rast se ka mjete atëherë të transferohen përmes llogarisë së veçantë të organit përbarues me qëllim të përmbylljes së obligimit. Në rast të mos realizimit me anë të llogarive bankare, të sekuestrohet kolaterali i debitorëve sipas kontratës së pengut dhe të njëjtat ti dorëzohen kreditorit për ti shitur, që nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorit, si dhe të detyrohen debitorët që të kompensojnë shpenzimet procedurale aq sa ato do jenë të llogaritura nga zyra përbarimore sipas udhëzimit Administrativ nr.06/2014 Udhëzim për tarifat për shpërblimet dhe kompensimin për përmbauesit privat.

I autorizuari i debitori i dytë me datën 20.08.2018, ka parashtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarim, ndër të tjerash ka theksuar se gjysma e kredisë është paguar duke e llogaritur edhe interesin e lartë dhe të njëjtat kanë qenë duke e paguar edhe këstet tjera sipas marrëveshjes. Ka shtuar se debitori i dytë ka rënë dakord për vazhdimin e pagesës së ratave mujore siç kanë rënë dakord, mirëpo ka propozuar një shumë më të vogël për shkak të mbylljes së biznesit për shkak të falimentimit, mirëpo banka nuk ka marr parasysh këto rrethana dhe ka ndërmarr veprime dhe ka dërguar lëndën në përbarim. I ka propozuar gjykatës që të anulohet urdhrin përbarim dhe të udhëzojë palët për të arritur një marrëveshje të re për vazhdimin e shlyerjes së obligimeve të mbetura.

Kreditori në përgjigjen në prapësimin e debitorit të dytë e ka kundërshtuar si të pas afatshëm, ndër të tjerash ka theksuar se ka për qëllim vetëm prolongimin e procedurës përmbartimore. Ka shtuar se prapësimi është i pasafatshëm pasi që debitori nuk ka vepruar komfor dispozitave të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimin ta refuzoj si të pa bazuar apo ta hedh poshtë si të paafatshëm.

I autorizuari i debitorit të tretë me datën 22.08.2018, ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme si dhe prapësim. Në kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme ka theksuar se Përmbartuesi Privat ka dorëzuar urdhrin në adresën Rruga Hajdar Dushi nr.5 B2, ndërsa G.B. ka adresën në Prishtinë në Rrugën “...” nr.11. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme për paraqitjen e prapësimin.

Në prapësimin e paraqitur e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, ndër të tjerash ka theksuar se përmbartimi është caktuar për sendet të cilat janë të përjashtuara nga përmbartimi, urdhri nuk është nxjerr sipas formës së paraparë me LPP. Ka shtuar se kërkesa e kreditorit bazohet në kërkesa të pa lejuara dhe se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin si të bazuar dhe urdhri për përmbartim të shfuqizohet.

Kreditori ka ushtruar përgjigje ndaj kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme dhe prapësimin të debitorit të tretë, duke i kundërshtuar si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se debitori ka për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës, dhe se prapësimi si i tillë është i pas afatshëm. Ka shtuar se konstatimet e debitorit kontrata e pengut për të qenë titull ekzekutiv duhet të ekzistoj kontrata e pengut dhe regjistrimi pengut janë konstatime të pa qëndrueshme sepse në dispozitat e marrëveshjes për pengun parasheh se penglënësi pranon dhe autorizon kreditorin të debitor të gjitha llogaritë rrjedhëse që janë lidhur me numër personal, dispozita këto që kreditorit i japin të drejtë që kërkesën e tij ta realizoj. I ka propozuar gjykatës që prapësimin ta refuzoj si të pa bazuar apo ta hedh poshtë si të pa afatshëm.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit të dytë është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.110/18 të datës 11.07.2018, të Përmbartuesit Privat Myjesere Mujku, debitori i dytë e ka pranuar me datë

17.07.2018, e cila vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 17.08.2018, siç vërtetohet nga vula e dorëzimit në postë.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori urdhrin përmbarimor, e ka pranuar me datën 17.07.2018, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 18.07.2018, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 24.07.2018. Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 17.08.2018, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me njëzet e katër ditë vonesë, rrjedhimisht gjykata vendosi si në dispozitivin I të këtij aktvendimi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të tretë të paraqitura në kërkesën për kthimin në gjendje të mëparshme, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i’u referuar dispozitës ligjore të nenit 68 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se kërkesa e debitorit është e bazuar, andaj të njëjtën e pranoi si të tillë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata fillimisht shqyrtoi afatshmërinë e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 130 par. 2 të LPK-së, me të cilën është përcaktuar se *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”*, vlerësoi se në rastin konkret debitor është njoftuar me datë 18.08.2018, se urdhri është dorëzuar në adresë të gabuar, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e ka paraqitur brenda afatit ligjor me datën 20.08.2018.

Gjykata konstatoi se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt propozimin për përmbarim dhe urdhrin përmbarimor konform dispozitave ligjore në fuqi, ngase nga shkresat e lëndës, konkretisht nga fletë kthesa e dorëzuar postë me datën 18.07.2018 në adresën “Prishtinë

Rruga Hajdar Dushi 5B2”, nuk mund të vërtetohet se debitori e ka pranuar personalisht propozimin për përmbarrim dhe urdhrin përmbarrimor, kjo për faktin se debitori me kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme ka bashkangjitur Certifikatën e vendbanimit B 10189398 të datës 20.08.2018, në të cilën konstatohet se adresa e tashme e debitorit është “Prishtinë Rruga ... nr.11”. Andaj, gjykata ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi gjithnjë duke u bazuar në dispozitën e nenit 68 par. 2 të LPP-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarrueshëm për përmbarrimin me dhunë.”* Në bazë të nenit 17 dhe 18 të LPP-së, lidhur me nenin 129 par.1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“Në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.”* Po ashtu në nenin 110 par. 1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“Padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t’i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar”,* rrjedhimisht gjykata lidhur me kërkesën për kthimin në gjendje të mëparshme vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të tretë paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorëve është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarrues dhe i përmban të gjitha

elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata duke vlerësuar Kontratën Kornizë për Limit të Produkteve Kreditore për Biznes me numër 157-2909-15 e datës 29.09.2015, Kontratën për Kredi Biznesi me numër K0115/4128 e datës 29.09.2015, Kontratën për kredi Biznesi me numër K0116/844 e datës 11.03.2016, Marrëveshjen për Peng mbi llogarinë Bankare për Bashkë huamarrësin me numër K0116/844 e datës 11.03.2016, Marrëveshjen Mbi Pengun me numër K0116/844 e datës 11.03.2016, Kontratën mbi Themelimin e Hipotekës me Nr.LRP.789/2015, Ref.1405/2015, gjeti se të njëjtat janë paraqitur në kopje të vërtetuara pranë organit kompetent, janë hartuar në formën e paraparë me ligj, dhe të njëjtat janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Aktvendimit mbi regjistrimin e Hipotekës nr.001-954-6-1022/15 i datës 06.10.2015 dhe Konfirmimin e Regjistrimit R-20160318-89 e datës 18.03.2016 dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22, pika 1.7 dhe 1.7a, lidhur me nenin 27 të LPP-së, për të qenë dokumente të përmbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësime tjera të paraqitura, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi,

si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.110/2022, datë 30.05.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.